



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:050235

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05746772

KE.Nr.2693/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit "Moncler S.P.A", Via Stendhal no.47, I-20144 Milano-Itali e përfaqësuar nga avokati Naser Peci, kundër të paditurit "Selo Tours Group" SHPK me NUI.811851113 me seli në Prishtinë, me adresë në Rr. "Bajram Kelmendi" Nr.15 e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Kushtrim Kastrati, me datën 21.05.2024, jashtë seancës mori këtë:

AKTGJYKIM

(- NË BAZË TË POHIMIT -)

- I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses "Moncler S.P.A", Via Stendhal no.47, I-20144 Milano-Itali e përfaqësuar nga avokati Naser Peci.
- II. VËRTETOHET se i padituri "Selo Tours Group" SHPK me NUI.811851113 ka shkelë Markën Tregtare verbale "Moncler", me numër 19444, markën figurative me numër 23188 dhe markën figurative me numër 19441.
- III. URDHËROHET shkatërrimin i 240 copë kapela për të rritur dhe 56 copë jakne dimërore për të rritur ne rastin 498-2022 që mbajnë shenjen Moncler dhe shenjen "M" të modifikuar dhe stilizuar me shpezë, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

IV. DETYROHET i padituri të paguajë shpenzimet edhe atë në emër të padisë dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën totale prej 150.00 eurove në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

#### A r s y e t i m

Paditësi, si në padinë e ushtruar në këtë gjykatë me datë 17.11.2022 dhe në fjalën përfundimtare gjatë seancës së datës 21.05.2024 nëpërmes përfaqësuesit të saj, ka mbetur në tërësi pranë pohimeve në padi dhe në kërkesëpadi, më të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesa e tij në tërësi si e bazuar dhe të vërtetohet se i padituri ka shkelë Markën Tregtare verbale "Moncler" me numër 19444, markën figurative me numër 23188 dhe markën figurative me numër 19441 me datën 21.10.2022, me rastin e importimit të 240 copë të kapelave për të rritur dhe 56 copë jakne dimërore për të rritur në rastin me numër 498-2022 që mbajnë shenjën "Moncler" dhe shenjën "M" me shpezë të stilizuar.

Sa u përket shpenzimeve procedurale i autorizuari i palës paditëse ka theksuar se nuk kërkojnë shpenzimet për përfaqësim të seancës së datës 21.05.2024, ndërsa ka kërkuar shpenzimet edhe atë për padi dhe për taksë gjyqësore në shumë totale prej 155.00euro, me propozim për gjykatën që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të merret aktgjykim në bazë të pohimit.

Përfaqësuesi i të paditurës Kushtrim Kastrati në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në kohën kur sasia e mallit është ndaluar nga ana e Doganës së Kosovës për të paditurin nuk ka qenë kontestues fakti se marka e shkelur dhe sasia e cila të njëjtit i është ndaluar shkelë Markën Tregtare, mirëpo i padituri pohon faktin se me rastin e ndalimit të mallit dhe pas verifikimit tek bartësi i së drejtës ai nuk kishte pranuar ndonjë njoftim zyrtar se kjo sasi e mallit shkelë Markën Tregtare, sepse po ta kishte pranuar me kohë ai do të nënshkruante dhe pranonte faktin se ka ndodhur shkelja e së njëjtës si dhe do të hiqte dorë nga shkelja e saj në të ardhmen, ku njëkohësisht me shpenzimet e tij do të përkujdesej për shkatërrimin e këtij malli nën mbikëqyrjen doganore.

Gjykata në kuptim të nenit 148 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore pas pohimit të kërkesëpadiës nga ana e të paditurit ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148 par.1 të LPK-së gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2693/22datë 21.05.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE: KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.